

PROGRAMI BACHELOR NË “EDUKIM FIZIK DHE SPORTE”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” synon të pajisë studentët me njohuritë dhe konceptet bazë të edukimit fizik dhe aftësitë praktike të nevojshme për të zhvilluar aftësitë fizike dhe motorike në një sërë disiplinash sportive si: atletika, gjimnastika, sportet individuale dhe kolektive. Gjithashtu synohet që të integrohet promovimi i shëndetit dhe praktikat e mirëqenies në edukimin fizik, duke siguruar që studenti të njohë rëndësinë dhe rolin e aktivitetit fizik në këtë drejtim. Programi ofron trajnim teorik dhe praktik në fushën e trajnimit sportiv, duke i aftësuar studentët për të stërvitur me efektivitet individë dhe ekipe.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në fund të programit të studimit studenti do të jetë i aftë:

- të njohë, kuptojë, përvetësojë dhe zbatojë teori, njohuri dhe koncepte bazë të fushës së edukimit fizik e sportit;
- të demonstrojë kompetencë në njohjen e aftësive të lëvizjes, si dhe të analizojë performancën e aftësive motorike (veçanërisht për aktivitetet sportive ekipore dhe individuale);
- të përdorë mjete dhe metoda për të vlerësuar performancën fizike dhe sportive të individëve dhe grupeve, për të përshtatur ushtrimet, ngarkesën dhe metodat e stërvitjes sipas veçorive fiziologjike, biomekanike dhe psikologjike të moshave dhe gjinive të ndryshme;
- të kuptojë dhe promovojë përfitimet e aktivitetit fizik për shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqenien, duke udhëhequr individët dhe grupet drejt një stili jetese të shëndetshëm, përmes ushtrimit të aktivitetit fizik e sportiv përkatës;
- të zhvillojë aftësi për të planifikuar, organizuar dhe menaxhuar aktivitete sportive dhe rekreative.
- të njohë dhe zbatojë standardet etike dhe profesionale në punën e tij/saj si edukator fizik apo trajner, duke ndërtuar një mjedis të sigurt dhe efektiv gjatë ushtrimit të profesionit në sportin përkatës.

PROFILI “GJIMNASTIKË”

- të demonstrojë kompetenca efektive si trajner i përgatitjes fizike në ekipet e gjimnastikës;
- të demonstrojë njohuri për edukimin fizik adaptiv në gjimnastikë.

PROFILI “FUTBOLL”

- të demonstrojë kompetenca efektive si trajner i ekipeve U-6 deri U-19;
- të demonstrojë njohuri dhe aftësi si trajner i përgatitjes fizike në ekipet e futbollit.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Mundësitë për punësim pas përfundimit të studimeve:

- Trajner dhe instruktor sportiv në klube sportive, veçanërisht ekipe futbollit, për moshat nga U-6 deri në U-19.
- Futbollist pranë ekipeve të futbollit.
- Trajner personal.
- Trajner i ekipeve të gjimnastikës.
- Gjimnast pranë ekipeve të gjimnastikës.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- Specialist për stërvitje të adaptuar.
- Specialist sportiv në administratë vendore ose qendrore.
- Instruktor në palestra, qendra fitnesi.
- Konsulent shëndeti dhe fitnesi.
- Organizator i aktiviteteve sportive.
- Koordinator i aktivitetit fizik dhe sportiv në OJF



BACHELOR "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15-20%/32 ECTS

1	I	1	Hyrje në Sociologji	6
2	I	2	Shkrim Akademik dhe Metoda kërkimi	8
3	I	1	Elemente të Edukimit Fizik	6
4	I	2	Anatomi Sportive	6
5	II	2	Mjekësi sportive	6
				32

B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/ 91 ECTS

1	I	1	Bazat e atletikës dhe gjimnastikës	8
2	I	2	Terapi e Lëvizjes dhe rehabilitim	8
3	I	2	Sporte Individuale dhe kolektive	8
4	II	1	Biomekanikë dhe Kinezologji	8
5	II	1	Fiziologji	6
6	II	2	Psikomotorrika e grupmoshave	8
7	II	2	Sporte në natyrë	10
8	II	1	Lojera Sportive dhe Rekreacion	10
9	III	1	Teori e stërvitjes sportive	8
10	III	1	Bodybuilding	5
11	III	1	Stërvitje e Adaptuar	6
12	III	2	Yoga dhe Pilates	6
				91

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE/ 12% - 15%/ 24 ECTS

PROFIL I:			Gjimnastikë	
1	II	2	Gjimnastikë I	8
2	III	1	Gjimnastikë II	8
3	III	2	Gjimnastikë III	8
PROFIL II:			Futboll	
1	II	2	Futboll I	8
2	III	1	Futboll II	8
3	III	2	Futboll III	8
				24

D - LËNDË PLOTËSUESE/ 10% - 15%/ 18 ECTS

1	II	1	Anglisht	5
2	I	1	Bazat e informatikës	4
3	I	1	Hyrje në psikologji	6
4	III	1	Hartim dhe menaxhim projektsh	6
5	III	2	Praktikë dhe zhvillim karriere	5
				26

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 3% - 5%/ 7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/ Provimi Përgjithshëm Përfundimtar	7
---	-----	---	--	---